

Marrëveshje Bashkëpunimi mes KGJK, KPK, PK dhe OAK



Marrëveshje Bashkëpunimi në mes të

Odës së Avokatëve të Kosovës

Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Këshillit Prokurorial të Kosovës

dhe

Policisë së Kosovës

**Në themelimin e mekanizmit koordinues për mbrojtje gjyqësore me shpenzime publike në
çështjet penale**

Me qëllim të zbatimit në praktikë të drejtës për mbrojtje gjyqësore me shpenzime publike në pajtim me ligjin e aplikueshëm në Kosovë dhe me instrumentet ndërkombëtare të aplikueshme në Kosovë, pajtohen si më poshtë:

**Neni 1
PALËT**

- I. Këshilli Gjyqësor i Kosovës (më tutje KGJK-ja) adresa në: Rr. "Luan Haradinaj" Prishtinë i përfaqësuar nga z. Nehat IDRIZI, Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- II. Këshilli Prokurorial i Kosovës (më tutje KPK-ja) adresa në: Rr. "Luan Haradinaj" Prishtinë i përfaqësuar nga z. Blerim ISUFAJ, Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- III. Policia e Kosovës (më tutje PK-ja) adresa në: Rr. "Luan Haradinaj" nr. 101. Prishtinë, i përfaqësuar nga z. Shpend MAXHUNI, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës;
- IV. Oda e Avokatëve të Kosovës (më tutje OAK-së) adresa në: Rr. "Qamil HOXHA" nr 10/3 i përfaqësuar nga z. Osman HAVOLLI, Kryetar i Odes së Avokateve të Kosovës.

**Neni 2
QËLLIMI**

1. Kjo Marrëveshje bashkëpunimi (MB) themelon mekanizëm funksional për mbrojtje gjyqësore me shpenzime publike në çështjet penale në mes të palëve nënshkruese, për të siguruar dhe ofruar shërbime efektive dhe profesionale të mbrojtjes gjyqësore me shpenzime publike, në pajtim me obligimet që dalin nga ligji i aplikueshëm, praktikat dhe standartet ndërkombëtare të aplikueshme në Kosovë.
2. Palët nënshkruese në mënyre pro-aktive do të promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e të pandehurve duke siguruar mbrojtje gjyqësore efektive dhe profesionale me shpenzime publike, nëse këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë në të gjitha fazat e procedurës penale.

Neni 3

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Policia e Kosovës

3.1 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Policia e Kosovës, pajtohen që:

- (a) Emërimi i avokatëve sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 57 dhe 58 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës do të koordinohet përmes Zyrës Koordinuese të OAK për shërbime gjyqësore sipas detyrës zyrtare në çështjet penale (Zyra Koordinuese).
- (b) Pas vendimit se avokati mbrojtës duhet emëruar në bazë të nenit 57 dhe 58 të Kodit të Procedurës Penale në një çështje penale, Zyra Koordinuese duhet të kontaktohet për emërimin avokatit të caktuar i cili do të sigurojë mbrojtjen gjyqësore në rastin e caktuar.

- (c) Procedurat nuk do të zhvillohen deri në njoftimin nga Zyra koordinuese e OAK lidhur me emërimin e avokatit mbrojtës sipas nën-paragrafit (b) të këtij nenit.
- (d) Asnjë avokat mbrojtës tjetër përveç atij të caktuar nga Zyra koordinuese e OAK, sipas nën-paragrafit (b) të këtij nenit, nuk do të mundet të ofroj mbrojtje gjyqësore sipas nenit 57 dhe 58 të Kodit të Procedurës Penale në rastin konkret, përveç nëse Zyra koordinuese e OAK dërgon njoftim me shkrim lidhur me zëvendësimin e avokatit mbrojtës tek Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial apo Policia e Kosovës.
- (e) Format e përfaqësimit do të vazhdohet të nënshkruhen nga zyrtari policor, prokurori apo gjykatësi sipas procedurave të aplikueshme nga institucionet respektive, duke përfshirë konfirmimin se avokati mbrojtës ka qenë prezent dhe ka përbushur obligimet e tij sipas ligjit të aplikueshëm.
- (f) Avokatët mbrojtës që ofrojnë përfaqësim gjyqësor sipas nenit 57 dhe 58 të Kodit të Procedurës Penale do të paguhen në baza mujore dhe jo pas çdo pjesëmarrje në çdo rast konkret.
- (g) Pagesa do të realizohet vetëm pas pranimit nga zyra kompetente të formularit të nënshkruar nga Zyra koordinuese e OAK, dhe verifikimit nga kjo zyrë se avokati mbrojtës është caktuar sipas dispozitave të këtij MB, për të ofruar përfaqësim gjyqësor me shpenzime publike në rastin/et konkret/e dhe vetëm pasi që formularit i janë bashkangjitur format përmes së cilave vërtetohet se përfaqësimi është siguruar sipas nën-paragrafit (b) të këtij nenit.
- (h) Një përqindje e pagesës mujore të avokatëve mbrojtës në rastet e përfaqësimit me shpenzime publike, e përcaktuar nga OAK përmes rregullores së brendshme, do të transferohet në OAK në baza mujore me qëllim të administrimit dhe koordinimit të mbrojtjes gjyqësore me shpenzime publike sipas nenit 57 dhe 58 të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 4 ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS

4.1 Oda e Avokatëve të Kosovës, do të:

- (a) Miratoj rregullore të brendshme që do të jetë e pranueshme për palët nënshkruese të kesaj MB, përmes së cilës në mënyrë të detajuar do të përcaktohet funksionimi i mekanizmit koordinues lidhur me mbrojtjen gjyqësore me shpenzime publike sipas nenit 57 dhe 58 të Kodit të Procedurës Penale dhe funksionimin e Zyrës koordinuese të OAK.
- (b) Do të themeloj dhe funksionalizoj Zyrën koordinuese të OAK, duke siguruar se e njëjta zyrë do të ketë personel adekuat, financiarisht stabile dhe të ketë mundësi për të funksionuar 24 orë, çdo ditë të vitit.
- (c) Të themeloj dhe mirëmbaj tre (3) lista të avokatëve mbrojtës të cilët do të përfaqësojnë klientët me shpenzime publike sipas obligimeve që dalin nga kjo Marrëveshje, si më poshtë:

- i. Lista e avokatëve mbrojtës të cilët do të duan të kontaktohen nga Policia e Kosovës pér të ofruar këshilla dhe mbrojtje gjyqësore te të arrestuareve;
 - ii. Listën e avokatëve mbrojtës që dëshirojnë dhe munden të përfaqësojnë klientët në çështjet penale para departamenteve të përgjithshme të gjykatave themelore; dhe
 - iii. Listën e avokatëve mbrojtës që dëshirojnë dhe munden të përfaqësojnë klientët në departamentet e specializuara të gjykatave themelore (departamenti pér krime të rënda dhe departamenti pér të mitur).
- (d) Zgjedhja e avokatëve mbrojtës sipas radhës pas pranimit të kërkesës nga autoritetet relevante në bazë të nenit 2, nën-paragrafi (b) dhe të sigurojë njoftimin me shkrim, përmes formës elektronike, me informatat lidhur me avokatin e caktuar, rastin në të cilin avokati është caktuar, dhe informatat kontaktuese të avokatit.
- (e) Të caktoj avokatin nga lista respektive sipas radhës, duke filluar nga avokatët të cilët janë caktuar në fillim të listës së përzgjedhjes.
- (f) Të sigurohet se vetëm avokatët me tre vite përvojë praktike apo më shumë si avokat, prokuror apo gjykatës munden të jenë pjesë e listës të cilët do të përfaqësojnë klientët në departamentet e specializuara të gjykatave themelore (departamenti pér krime të rënda dhe departamenti pér të mitur).
- (g) Të evitojnë çdo konflikt interesit të mundshëm gjatë caktimit të avokatëve mbrojtës në rastet e përfaqësimit sipas detyrës zyrtare.
- (h) Të caktoj zëvendësimin e avokatëve në rastet e konfliktit të interesit apo nëse fillimi shëtë caktuar avokati i njëjti nuk është në gjendje pér të ofruar shërbimet.
- (i) Të siguroj se avokatet do të vazhdojnë të ofrojnë shërbime në rastet në të cilat janë caktuar pa marr parasysh nëse të njëjtët e kanë arritur maksimumin e pagesës mujore.
- (j) Në mënyre pro-aktive të monitorojnë performancën e avokatëve të caktuar sipas kesaj marrëveshje, duke përfshirë pyetësorët me klient, të sigurohet se të njëjtit i kryejnë obligimet e tyre në bazë të standardeve të pranueshme dhe në pajtim me obligimet e tyre etike.
- (k) Të sigurohen se avokatet që nuk i kryejnë obligimet e tyre në pajtim me nën-paragrafin (h) do të tërhiqen nga lista e avokatëve sipas nën-paragrat (c) dhe rasti pér sjellje jo-professionale të drejtohen të Zyra e Prokurorit Disiplinor të OAK.
- (l) Të paraqes raport vjetor të punës tek KGJK, KPK, PK, lidhur me performancën e Zyrës koordinuese të OAK dhe avokatëve të caktuar sipas kësaj MB.

Marrëveshje Bashkëpunimi mes KGJK, KPK, PK dhe OAK

**Neni 5
MOSMARRËVESHEJET EVENTUALE**

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Policia e Kosovës dhe Oda e Avokateve të Kosovës pajtohen se për çdo mosmarrëveshje apo keqinterpretim lidhur me natyrën dhe qëllimin e bashkëpunimit që del nga kjo Marrëveshje do ta zgjedhin përmes bisedimeve dhe mirëbesimit të ndërsjellët.

**Neni 6
ZBATIMI**

Palët pajtohen se do të kujdesën për zbatimin me përkushtim dhe përpikëri të kësaj Marrëveshje.

**Neni 7
VLEFSHËMIRA KOHORE E MARRËVESHJES**

Palët nënshkruese pajtohen që vlefshmëria kohore e kësaj marrëveshje të jetë në afat të pa caktuar, ndryshim-plotësimi apo prishja e kësaj marrëveshje, mund të bëhet në çdo kohë vetëm me kërkesë me shkrim të parashtruar nga palë nënshkruese.

**Neni 8
NËNSHKRIMI DHE HYRJA NË FUQI**

Marrëveshja është nënshkuar në katër (4) kopje identike origjinale, në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze, nga një (1) kopje për secilën palë nënshkruese dhe e njëjtë hyn në fuqi tridhjetë (30) ditë pas miratimit të Rregullores të paraparë sipas kësaj Marrëveshje.

Nënshkuar dhe vulosur në Prishtinë, me 26 Prill 2016

Për Këshillin Gjyqësor

Nehat IDRIZI, Kryesues

Për Policinë e Kosovës

Shpend MAXHUNI, Drejtor i Përgjithshëm

Për Këshillin Prokurorial

Blerim ISUFAJ, Kryesues

Për Odën e Avokatëve të Kosovës

Osman HAVOLLI, Kryetar

